



ALB-AUDIT

ALB-AUDIT sh.p.k
Rr. EMIN DURAKU
Nd.2, H.6, Ap.10
Njësia Bashkiake Nr.6, Kodl Postar 1019
TIRANE
NIPT: L 01417011 K
Tel/fax: +35542251744, Cel: 0692042251
Email: a@audit@omail.com, ihsh@i@vahoo.com

Reporti javor i ndërmjetëm monitorimi, periudha 17-23 Qershor 2019

Për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve
Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

Monitorues/Eksperti financiar: Hatem Sulaj

Zgjedhjet: Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 30 Qershor 2019

Partia/subjekti elektoral: Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE)

Ne jemi angazhuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në misionin e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore, 30 Qershor 2019, të **Partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE)**. Monitorimi të procesit filloi me nënshkrimin e kontratës, datë 01 Qershor 2019 dhe vazhdoi gjatë diteve në vijim.

Objektivat e monitorimit dhe kriteret e kundrejt të cilave do të vlerësohet dhe matet shkalla e pajtueshmërisë së fushatës zgjedhore janë sintetizuar në Udhëzimin e KQZ-së, Nr.2, datë 01.06.2017, nenin 3 të tij.

Të dhëna mbi subjektin dhe organizimin e fushatës zgjedhore

Nga të dhënat e publikuara dhe të dërguara nga KQZ për ekspertet financiar, **Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE)**, është regjistruar si subjekt zgjedhor si pjese e Aleancës për Shqipërinë Europiane dhe në të gjitha bashkë mbështet kandidatin e aleancës.

Ndërsa kanë depozituar dhe deklaruar lista shumëemërore për këshilltarë bashkiakë në 11 bashki.

Duke filluar nga dita e parë dt.17.06.2019 e javës së tretë e monitorimit vazhdojmë të jemi në kërkim të informacioneve nga drejtuesit e fushatës së partisë për të njohur me organizimin e fushatës, zyrat dhe aktivitetet e planifikuara të fushatës deri në përfundim të saj. Deri në datën e hartimit të këtij raporti nuk kemi marrë ndonjë informacion për ndonjë aktivitet që do të zhvillohet nga kjo parti.

Objektivat e javës së tretë të monitorimit

Paralelisht me kërkesat për informacion kërkuar partisë por edhe bashkive nëpërmjet portalit edhe në portalin www.pyetshtetin.al, ne vazhduam monitorimet e zyrave dhe aktiviteteve duke përdorur gjykimin profesional në zgjedhjen e tyre.

Në këtë fazë, fokusi i monitorimit ishin ekzistenca e zyrave elektorale dhe aktiviteteve të organizuara nën siglen e partisë, me objektivin:

- Mbledhjen dhe raportimin e gjetjeve që kishin të bënin me kontrollin e zbatimit të ndalimeve dhe kufizimeve të përcaktuara në Udhëzimin Nr.1 datë 31.05.2017 të KQZ-së, i cili kërkon që: përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike të jetë në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor dhe, subjektet zgjedhore lejohen të ngrenë jo më shumë se një zyrë elektorale për lagje qyteti ose fshat.
- Sigurimin e informacionit financiar dhe jo financiar dhe lidheshin me shpenzimet e destinuara për fushatën, dhe kryesisht në evidentimin e elementëve të kostove të zyrave dhe aktiviteteve, llojin dhe madhësitë e ambienteve, sasitë e materialeve publitare të përdorura, dokumentimin e shpenzimeve me fatura blerje etj, të dhëna që do të përdoren fazat vijuese.

Rezultatet e monitorimit dhe gjetjet

Rajoni dhe/ose bashkia të monitoruara:

Për periudhën 17-23 Qershor 2019 janë vëzhguar bashkitë si më poshtë vijon:

Nr	Bashkitë e monitoruara në terren	Evidenca e marrë-gjetjet, 1-10 Qershor 2019		
		Ekzistenca e zyrave	Aktivitetet zgjedhore	Materiale të fushatës të ndaluara
1	Fier	Nuk janë gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivitete	Nuk ka publicitet fushate
2	Patos	Nuk janë gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivitete	Nuk ka publicitet fushate
3	Divjak	Nuk janë gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivitete	Nuk ka publicitet fushate
4	Këlçrë	Nuk janë gjetur zyra zgjedhore	Nuk ka patur aktivitete	Nuk ka publicitet fushate

Po ashtu dhe nga ndjekja e emisionit të lajmeve në media radio e televizion nuk kemi konstatuar aktivitete që kanë lidhje me fushatën e kësaj partie.

Shkeljet e mundëshme të identifikuara të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore

Zyrat elektorale

- Në bashkitë e monitoruara në terren nuk u evidentuan zyra elektorale që perdoreshin nga **Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE)**.

Aktivitete zgjedhore

Nuk u evidentuan aktivitete të organizuara nga **Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE)**.

Materiale të fushatës të ndaluara

- Nuk u evidentuan në asnjë rast materiale me natyrë publicitare dhe propagandistike dhe kosto me natyrë zgjedhore.

Rezultatet e takimeve me drejtuesit e partisë dhe gjetjet

Më datë 19.06.2019 arritëm të kontaktonim me telefon me z. Altin Kaso, financierin e partisë, me nr.tel.069606477 dhe me email:vamus1948@gmail.com dhe në datën 20.06.2019 morëm takim në zyrat e ekspertit financiar. Z. Altin Kaso ju kërkua informacion mbi financat dhe shpenzimet e partisë për fushatën zgjedhore, por nga deklaratimet verbale të bëra nga personi i mesipërm nuk u konstatua që partia të mbante financa pasi nuk kishte asnjë të ardhur si nga fondet publike ashtu dhe nga fondet jopublike si dhe nga kuata antarsie. Njëkohësisht me deklarim që asnjë shpenzim nuk është kryer nga ana e partisë për fushatën zgjedhore të 30-Qershorit.

Më datë 21.06.2019 arritem të kontaktonim me telefon me z. Valentino Mustaka, kryetar i partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE), me nr.tel.0682058712 dhe me email:vamus1948@gmail.com dhe në datën 22.06.2019 morëm takim në Durrës. Z. Valentino Mustaka, ju kërkua informacion mbi financat dhe shpenzimet e partisë për fushatën zgjedhore, por nga deklaratimet verbale të bëra nga personi i mesipërm nuk u konstatua që partia të mbante financa pasi nuk kishte asnjë të ardhur si nga fondet publike ashtu dhe nga fondet jopublike si dhe nga kuata antarsie. Përveç deklaratimeve verbale, me datë 23.06.2019 z. Valentino Mustaka, kryetar i partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE), na dëgjon shkresën për informacion lidhur me aktivitetet dhe shpenzimet për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e datës 30-Qershor.

Në shkresën e mësipërme kryetari i partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE), z. Valentino Mustaka na deklaroi:

"Partia jonë ABDE, pjesëmarëse në zgjedhjet e 30 qershorit 2019 në 11 bashki për kandidat për këshilltar gjatë javës që mbyllëm ka patur aktivitete individuale me banorët në bashkitë respektive duke grumbulluar me grupe të vogla njohës personal.

Nga ana e kqz nuk ka bërë asnjë financim sipas asaj që ka publikuar, si e tillë asnjë prej kandidatëve nuk ka bërë shpenzime për fushatën, thjesht janë bërë takime me shokë e miq të çdo kandidati.

Njerëzit janë në dilemë për zhvillimin e zgjedhjeve sado që ne i themi se ato do të mbahen në datën e caktuar dhe dëshira jonë kështu është".

Bashkangjitur do të gjeni shkresën për informacion të dërguar me email nga z.Valentino Mustaka, kryetar i partisë Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane (ABDE).

Monitorues/Ekspert i financiar

Hetem Sulaj

Tiranë, më 24 Qershor 2019